



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË



INSTITUTI I HISTORISË



KOMUNA E FERIZAJT

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË; INSTITUTI I HISTORISË DHE
KOMUNA E FERIZAJT

Organizon
Konferencë shkencore

në temën:
"Ferizaj në rrjedhat e historisë"*

10 qershor 2023

Karakteri dhe qëllimi i konferencës. Konferenca mëton, që nëpërmjet kumtesave dhe diskutimeve, me rastin e 150 vjetorit të themelimit të qytetit të Ferizajt të trajtojë në mënyrë kreative dhe shteruese tema si: "Autoktonia e trevës së Ferizajt", "Kuvendi i Ferizaj 1908"; Roli i Ferizajt në kryengritjet e përgjithshme kundër Perandorisë Osmane 1908-1912; "Jeta sociale dhe kulturore e Ferizajt ndër shekuj"; "Kontributi i gruas së Ferizajt në lëvizjet politike"; "Ferizaj dhe demonstratat anti sistem", "Trashëgimia kulturore e Ferizajt dhe e rrethinës së tij" etj. Konferenca ka karakter kombëtar, thellësisht shkencor dhe synon të mbledhë studiues nga fusha e historisë, dhe jo vetëm, nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, të cilët me kontributet e tyre do të arrijnë të analizojnë dhe ndriçojnë aspekte dhe dimensionet e reja të temës bosht të kësaj konference.

Tezat e mundshme për trajtim dhe diskutim:

- Kryengritjet në rajonin e Ferizajt në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit;
- Kuvendi i Ferizajt (1908);
- Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 – roli dhe kontributi i Ferizajt;
- Zhvillimi i bisedimeve shqiptaro-osmane në Ferizaj dhe çlirimi i Shkupit;
- Pushtimi i Ferizajt nga forcat serbe dhe rezistenca e shqiptarëve më 1912;

* Titulli i konferencës si dhe tezat e mundshme për trajtim dhe diskutim në këtë konferencë mund të ndryshojnë në varësi nga diskutimet me ekspertët dhe inkorporimet e ideve të tyre.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË



INSTITUTI I HISTORISË



KOMUNA E FERIZAJT

- Ferizaj gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore;
- Ripushtimi i Ferizajt (tetor 1918) nga forcat serbe;
- Zhvillimi i Rezistencës së armatosur guerile (Lëvizjes Kaçake) në trevën e Ferizajt
- Zhvillimet politike dhe socio-ekonomike në Ferizaj në periudhën ndërmjet Dy Luftërave Botërore;
- Ferizaj gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Zhvillimi i arsimit dhe i kulturës në Ferizaj në vitet e Luftës së Dytë Botërore;
- Gjendja e Ferizajt në fund të Luftës së Dytë Botërore;
- Veprimtaria e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH) në Ferizaj dhe krerët e saj;
- Zhvillimi i veprimtarisë së Lëvizjeve të Fshehta (Ilegale) në rajonin e Ferizajt;
- Organizimi dhe zhvillimi i demonstratave gjithpopullore në Ferizaj më 1968 dhe 1981;
- Demonstrata e vajzave dhe grave të fshatit Balaj më 23 mars 1989
- Zhvillimi ekonomik dhe socio-kulturor i Ferizajt në periudhën 1945-1990;
- Jeta politike në Ferizaj në vitet '90-të;
- Zona Operative e Nerodimes dhe zhvillimi i rezistencës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në trevën e Ferizajt;
- Kontributi i Ferizajt në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Përshkrimi i aktiviteteve:

Konferenca është një ditore dhe përmban pjesën solemne dhe atë shkencore. Në pjesën protokollare do të paraqiten me fjalë rasti përfaqësues të institucioneve qendrore të Kosovës, Rektori i UP-së, Dekani i Fakultetit Filozofik, si dhe kryetari i Komunës së Ferizajt, ku edhe do të mbahet konferenca.

Pjesa shkencore zhvillohet me pjesëmarrësit e paraqitur me kumtesa dhe ofron mundësinë për të lexuar, debatuar apo ofruar çfarëdo kontributi shkencor lidhur me temën bosht të konferencës.

Pjesëmarrësit në Konferencë:

Studiues nga universitete dhe institute shkencore nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe vende të tjera.

Kriteret e përgatitjes dhe leximit të kumtesës

Secili pjesëmarrës do të ketë në dispozicion 7-10 minuta kohë për elaborim të kumtesës. Kumtesat për konferencë duhet të jenë të gjata përfaqësuesisht 4 faqe. Të gjitha punimet duhet të jenë origjinale dhe të mos paraqiten njëkohësisht në një revistë ose konferencë tjetër. Punimet për botim pranohen



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË



INSTITUTI I HISTORISË



KOMUNA E FERIZAJT

në gjuhën shqipe (vetëm abstrakti duhet të jetë edhe në gjuhën angleze). Punimet duhen dërguar në adresën elektronike në vijim: mentor.hasani@uni-pr.edu

Informacionet e nevojshme për formatimin e punimit

Abstrakti duhet të shkruhet në fletë standarde A4 me hapësirë 1" në të gjitha anët, me fond 12 Times New Roman dhe hapësirë 1.5. Abstrakti duhet të përmbajë: Titullin, (150-300 fjalë). Pas titullit duhet të vendosen informacionet në lidhje me autorin (Emër, Mbiemër, Institucioni, ku punon).

Shpenzimet e akomodimit, ushqimit dhe transportit mbulohen nga organizatorët. Për secilën kumtesë do të jetë nga një honorar.

Abstraktet në versionin përfundimtar do t'i nënshtrohen një vlerësimi nga Këshilli Shkencor dhe do të botohen në një libër abstraktesh në formë të printuar, për ditën që do të mbahet konferenca.

Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve: 15 maj 2023 në adresën elektronike: mentor.hasani@uni-pr.edu

Njoftimi i pranimit të punimit bëhet më 31 maj 2023, datë kur edhe ju dërgohet agjenda e konferencës.